



Republika e Maqedonisë

**KOMISIONI SHTETËROR I ZGJEDHJEVE**

Nr. \_\_\_\_\_

\_\_\_\_\_ **2014 SHKUP**

Në bazë të nenit 31 paragrafi 2 alineja 2 të Kodit zgjedhor („Gaz.zyrtare e Republikës së Maqedonisë nr. 40/06, 136/08, 148/08, 155/08, 163/08, 44/11, 51/11, 54/11 – Tekst i pastruar, 142/12, 14/14 dhe 32/14 – Tekst i pastruar) Komisioni Shtetëror i zgjedhjeve, në seancën e mbajtur më 21 shkurt 2014, miratoi

**UDHËZIM**

**për implementimin e nenit 113 paragrafi 3 të Kodit zgjedhor  
-për persona të cilët gjenden në vuajtje të dënimit e masave burg shtëpiak**

1. Zgjedhësi i cili në ditën e zgjedhjeve, gjendet në vuajtje të dënimit e masave burg shtëpiak, nëse dëshiron ta realizojë të drejtën e vet të votës, në afat prej tri ditëve me anë të personit të autorizuar duhet ta njoftojë Komisionin komunal të zgjedhjeve kompetent.
2. Komisionin komunal të zgjedhjeve, në bazë listës të pranuar më parë për personat të cilët gjenden në vuajtje të dënimit e masave burg shtëpiak (neni 43 paragrafi 2 të Kodit zgjedhor) nga ana e Komisionit Shtetëror të zgjedhjeve, për personave të paraqitur në mënyrë të rregulltë përpilon listë.
3. Votimin e personave të cilët gjenden në vuajtje të dënimit e masave burg shtëpiak e zbaton këshilli zgjedhor i vendvotimit përkatës ku është i regjistruar zgjedhësi.
4. Votimin e personave të cilët gjenden në vuajtje të dënimit e masave burg shtëpiak, këshilli zgjedhor e zbaton një ditë para ditës së zgjedhjeve, në kuti të votimit e cila është e mbyllur dhe e merr me vehte në shtëpinë ku gjendet zgjedhësi.
5. Kryetari i Komisionit komunal të zgjedhjeve, i njofton përfaqësuesit e autorizuar të parashtruesve të listave për ditën dhe kohën e votimit të personit i cili gjendet në vuajtje të dënimit e masave burg shtëpiak.
6. Këshilli zgjedhor, në ditën e zgjedhjeve këtë lloj të votimit e shënon në procesverbal (Formulari numër 16)
7. Zgjedhësi i cili në ditën e zgjedhjeve, gjendet në vuajtje të dënimit e masave burg shtëpiak, voton në mënyrë Komisioni komunal i zgjedhjeve që e përgadit materialin zgjedhor dhe në kohë ia dërgon këshillit kompetent zgjedhor (kuti të zbrazur votimi dhe zarf i adresuar në emër të personit të cilit iu është shqipëtuat masat e dënimit burg shtëpiak)

8.Këshilli zgjedhor, para se të fillojë me votimin e personave të cilët gjenden në vuajtje të dënimit e masave burg shtëpiak, nga blloku amë(koçani) këput aq fletvotime sa persona ka të evidentuar për vendvotimin përkatës.

9.Këshilli zgjedhor, gjatë zbatimit të votimit të personave të cilët gjenden në vuajtje të dënimit e masave burg shtëpiak e përdorë kutinë e votimit të cilën ia ka dorëzuar Komisionit komunal të zgjedhjeve për këtë votim dhe e njëjta do të përdoret në ditën e zgjedhjeve. Këshilli zgjedhor, me vehte mban edhe ekstraktin e Listës zgjedhore ku nënshkruhet personi i cili gjenden në vuajtje të dënimit e masave burg shtëpiak

10. Para se të fillojë votimi, kapaku i kutisë së votimit duhet të jetë i mbyllur nga të dy anët me shirit sigures plastik të numeruar.

11.Këta persona votojnë në mënyrën e verifikuar në nenin 109 dhe 110 të kodit zgjedhor dhe të njëjtëve iu mundësohet fshehtësia e votimit.

12. Pas mbarimit të votimit, zarfet me fletëvotime mbeten në kuti të votimit, ndërsa vrima e kapakut mbyllet me shirit sigures plastik të numeruar.

Ekstrakti i Listës zgjedhore, bashkë me bllokun amë(koçanin) e fletëvotimeve vihen në një thes klastiku të dejdukshëm dhe mbyllet me shirit sigures plastik të numeruar.

13 Nëse personi i cili gjenden në vuajtje të dënimit e masave burg shtëpiak, edhe pse është i paraqitur se dëshiron të votojë refuzon të bëjë atë, fletëvotimi nuk guxon të përdoret në ditën e zgjedhjeve por i këputet këndi i poshtëm i djathtë dhe ruhet në zarf të posaçëm dhe në ditën e zgjedhje gjatë sumimit të rezultateve, evidentohet bashkë me fletëvotimet tjera të papërdorura.

14.Kutia e votimit në ditën e zgjedhjeve para fillimit të votimit hapet, nxirren zarfet dhe hapen një nga një, fletëvotime pa u parë se për cilin është votuar vendosen në kuti të zbrazur të votimit. Kutia e votimit në të dy anët e kapakut mbyllet me shirit sigures plastik të numeruar.

**KOMISIONI SHETËROR I ZGJEDHJEVE**  
**KRYETAR**  
**Nikolla Rillkoski**